



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

RAPORT

MBI MBLEDHJEN E KOMISIONIT PËR POLITIKËN E JASHTME

PËR SHQYRTIMIN E PROJEKTLIGJIT

“PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT”

Hyrje

Më 12 shkurt 2019 Komisioni për Politikën e Jashtme u mbledh me këtë rend dite:

1. Miratimi i kalendarit tre javor të punimeve të Komisionit;
2. Miratimi i procesverbaleve të datave 23 dhe 24 janar 2019;
3. Projektligji “Për ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”;
4. Çështje të tjera.

Të ftuar

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit “Për ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut” ishin të pranishëm:

- Znj. Artemis Dralo, Zv. Ministre, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Z. Petro Koçi, Zv. Ministër në Ministrinë e Mbrojtjes
- Z. Armand Skapi, Drejtor i Traktateve në MEPJ
- Z. Ilir Melo, Drejtor i Drejtorisë së Rajonit dhe Vendeve Fqinjë në MEPJ
- Kol. Petrit Çuni, Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH
- Z. Gjergj Methoxha, Drejtor i Drejtorisë së Politikave të NATO dhe BE në MM

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Baza Kushtetuese e projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim ishte propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohej me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji, rezultoi se fusha që rregullon ky projektligj përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të miratimit me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Komisioni për Politikën e Jashtme e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Diskutimet

Znj. Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit, pas miratimit të kalendarit dhe proces-verbaleve, kaloi në diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Ajo theksoi se ky projektligj është i një rëndësie të veçantë. Ai ka të bëjë me një moment historik të fqinjët tonë Maqedonisë së Veriut për të cilin ajo ka punuar fort dhe që u be i mundur pas kapërcimit të problemit të emrit nëpërmjet marrëveshjes së Prespës midis Shkupit dhe Athinës. Shqipëria është një nga vendet e para që do të ratifikojë këtë marrëveshje duke treguar interesin e saj për forcimin e sigurisë të fqinjët tonë dhe rajonit.

Me pas znj. Kodheli ftoi znj Artemis Dralo, Zv. Ministre në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe z. Petro Koçi, Zv. Ministër në Ministrinë e Mbrojtjes për të paraqitur projektligjin.

Z. Tritan Shehu, Zv. Kryetar i Komisionit, ndërhyri për çështje procedurale duke bërë vërejtje dhe kërkuar shpjegime se përse Komisioni për Politikën e Jashtme e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi dhe jo të atij përgjegjës.

Znj Artemis Dralo, Zv. Ministre në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme u shpreh se Projektligji synon ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut të Veriut për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nënshkruar më 6.2.2019, në Bruksel. Më tej ajo paraqiti relacionin e qeverisë për projektligjin duke u ndalur tek qëllimi i tij dhe objektivat që synohen

të arrihen, konteksti politik dhe institucional, vlerësimi në raport me programin e qeverisë, ligjshmërinë dhe politikën e jashtme të Shqipërisë. *(shih relacionin – shënimi ynë)*.

Z. Petro Koçi, Zv. Ministër në Ministrinë e Mbrojtjes u shpreh se hyrja e Maqedonisë së Veriut në NATO është një investim i drejtpërdrejtë në sigurinë e saj, një pjesë të kombit shqiptar që jeton në këtë vend si element shtet formues por edhe të rajonit të Ballkanit i cili përfshihet me shume në çadrën e garancisë që ofron Aleanca dhe rezen e vlerave demokratike të saj.

Z. Ditimir Bushati, anëtar i Komisionit dhe relator u shpreh se bashkohej me vërejtjet e z. Tritan Shehu përse i përket cilësisë në të cilën Komisioni po e shqyrtonte këtë projektligj. Në fakt, para së gjithash, NATO është një organizatë politike dhe besoj se ky gabim i Konferencës së Kryetarëve shpresoj të këtë qenë thjesht një lapsus, jo një gabim konceptual, tha ai. Këtu çështja nuk qëndron nëse do ta kalojmë me konsensus apo jo këtë akt, sepse besoj se asnjëri nga ne nuk ka dyshimin më të vogël në përkatësinë atlantiste të klasës politike shqiptare apo të paktën të konfigurimit aktual të parlamentit shqiptar, por kjo është një çështje që ka të bëjë me mënyrën se si konceptohet kjo organizatë dhe prania jonë në këtë organizatë, theksoi z. Bushati. Me tej ai bëri një sërë vërejtjesh për relacionin e paraqitur nga qeveria si dhe disa propozime për riformulimin e tij. *(shih relacionin dhe proces-verbalin – shënimi ynë)*

Znj. Mimi Kodheli sqaroi se përse i përket çështjes procedurale të cilësisë në të cilën Komisioni po e shqyrtonte këtë projektligj është ndjekur precedenti i procedurës së zbatuar në rastin analog të shqyrtimit të projektligjit “Për ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Malit të Zi”.

Z. Tritan Shehu deklaroi votën PRO të tij dhe të forcës politike që ai përfaqëson. Ai iu bashkua komenteve të bëra nga z. Ditimir Bushati dhe theksoi rolin e shqiptareve që janë një element shtet formues i Maqedonisë së Veriut në arritjen e këtij suksesi. Gjithashtu ai vlerësoi edhe kontributin e politikës së jashtme shqiptare në favor të stabilitetit në rajon dhe respektimit të kufijve që do të sfumohen në kuadrin e integritetit evropian. Me tej ai bëri një sere kritikash lidhur me raportin, me mospjesëmarrjen e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme në paraqitjen e këtij projektligji si dhe me delegimin e kompetencave të tij.

Znj. Mimi Kodheli dhe Znj. Vasilika Hysi, anëtare e Komisionit tërhoqën vëmendjen për ruajtjen e etikes dhe retorikë të përmbajtur nga diskutantët *(shih proces-verbalin – shënimi ynë)*.

Z. Ervin Bushati, anëtar i Komisionit u shpreh se hyrja e Maqedonisë së Veriut në NATO është një lajm i mire për të, për Shqipërinë, Ballkanin dhe vetë NATO-n që është një garante e sigurisë dhe vlerave. Maqedonia ka bërë një progres të mrekullueshëm, tha ai. Kjo është një

ditë e madhe dhe ne duhet të qëndrojmë në nivelin e solemnitetit dhe rëndësisë së saj duke ruajtur frymën e pozitivitetit.

Znj. Klajda Gjoshë, zv. Kryetare e Komisionit u shpreh se të gjitha votat shkojnë pa asnjë mëdyshje në favor të projektligjit të paraqitur. Znj. Gjoshë theksoi gjithashtu rolin e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut si një faktor deciziv në arritjen e këtij suksesi. Ndërkohe ajo iu bashkua qëndrimit të z. Tritan Shehu lidhur me pjesëmarrjen dhe prezantimin e projektligjit nga vetë Ministri i dekretuar për Evropën dhe Punët e Jashtme

Znj. Mimi Kodheli, në përfundim të diskutimeve, ftoi Komisionin për të votuar projektligjin.

Komisioni për Politikën e Jashtme miratoi unanimitasht projektligjin “Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

RELATOR

KRYETARE

Ditmir BUSHATI

Mimi KODHELI